


TA DUAM TONËN



DEMOKRACI

DEMOKRACIA DHE RËNDËSIA E SAJ

JON O. (14), AULON (15), ARLIND (14), JON M. (15), DJELLZA (14), BLEND (14), REJAN (14)



Në këtë artikull ju do të lexoni mbi historinë e demokracisë, zgjedhjet dhe Kushtetutën

Kosova është një prej shteteve më të reja në rajon dhe botë dhe është një shtet i pavarur në Evropën Juglindore që nga data 17 Shkurt 2008. Forma e qeverisjes në Kosovë është demokracia, që rrjedh nga fjala greke që do të thotë „demos“ popull, „kratia“ rend ose sundim. Ajo saktësisht është një formë qeverisjeje në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve. Të jesh sovran do të thotë të jesh i lirë, të kesh të drejtat e tua. Demokracia për herë të parë u paraqit në vitin 507 p.e.s në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë. Atëherë kanë pasur të drejtë të votojnë vetëm burrat e pasur, pastaj me kalimin e kohës filluan të votojnë edhe gratë.

Kushtetuta është ligji apo akti juridik kryesor i një vendi. Ligjet dhe rregulloret tjera të shtetit duhet të jenë në përputhje me dispozitat e kushtetutës. Në disa vende, kushtetuta njihet edhe si ligj themelor apo statut themelor. Edhe pse jemi të lirë dhe kemi të drejtat tona, prap se prap ne jemi të obliguar t'i respektojmë ligjet e vendit tonë.


Njëra prej parimeve të demokracisë është liria e çdo qytetari, pa dallim gjinie, moshe, race apo religjionit fetar. Në rast se ligjet shkelen, atëherë me vendosjen e drejtësisë merren gjykatat.

Në jetën e përditshme, kemi të drejtë të zgjedhim p.sh. çfarë libri të lexojmë, çfarë muzike të degjojmë, mirëpo për të marrë pjesë në zgjedhjet e sistemit

demokratik, nuk është e lejueshme të marrim pjesë nën moshën 18 vjeçare. Jo rastësisht është caktuar kjo moshë, sepse mosha 18 vjeçare është mosha kur fëmijët pavarësohen nga prindërit e tyre, pra mosha e pjekurisë. Në këtë moshë, jemi më të vetëdijshëm se për kë të votojmë. Andaj një votë është shumë e rëndësishme, sepse ajo bën ndryshimin e një shteti. Zgjedhjet në demokraci janë proces gjatë të cilit populli zgjedh përfaqësuesit e tyre. Ato ndahen në dy (2) lloje: qendrore dhe komunale. Në zgjedhjet qendrore votohen deputetët, kurse në zgjedhjet komunale, votohen kryetarët e komunave dhe assembleistët. Pra, ne kemi të drejtë që të shprehim mendimet tona, të shprehemi lirshëm dhe këto mundësohen nga sistemi demokratik i vendit tonë, Kosovës.




Autorët e këtij artikulli



Ti vendos, ti e bën zgjedhjen!



Vetëm me punë do ecim para



Elementet bazë të demokracisë



Duke vizatuar për artikullin e gazetës




Të bashkuar kemi rezultate më të mira



Të drejtat dhe përgjegjësitë tona

NDARJA E PUSHTETIT

LUAR (14), ARON (14), EGZON (14), ALTIN (15), FATLUM (14), ALSA (14), LORENA (14)



Në artikullin më poshtë, do të mësoni se pse bëhet ndarja e pushtetit

Në Republikën e Kosovës ndarja e pushtetit bëhet në tri degë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor. Kjo ndarje e pushtetit bëhet në mënyrë që secili pushtet të punoj në mënyrë të pavarur dhe ta kryej detyrën e tij sa më mirë.

Ndarja e pushtetit i mundëson vendit funksionim të mirë dhe adekuat. Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi i cili bënë miratimin e ligjeve.

Në Kuvend bëjnë pjesë 120 deputetë, ku 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë. Këta deputetë zgjedhen nga votat e popullit. Të drejtë vote ka çdo qytetar i moshës 18 vjeçare. Kuvendi ka tre funksione kryesore të cilat janë: funksioni legjislativ, funksioni përfaqësues dhe funksioni mbikëqyrës.

Rol tjetër të rëndësishëm ka edhe Pushteti Ekzekutiv. Në këtë pushtet bën pjesë Qeveria, e cila merret me zbatimin e ligjeve të marra nga Kuvendi. Në Qeveri bëjnë pjesë: Kryeministri, ministrit dhe zëvendësiministrit.

Qeveria i propozon Kuvendit buxhetin e vendit dhe ka të drejtën e paraqitjes së projektligjeve.

Rol tjetër të rëndësishëm ka edhe pushteti gjyqësor. Nga vet fjala mund ta kuptojmë se në të bëjnë pjesë gjykatat.

Gjykata merret me zbatimin e drejtësisë së vendit. Roli i gjykatave është të shikoj se mos i thyen ndokush ligjet. Kemi tri lloje të gjykatave : Gjykata Themelore,

e Apelit dhe Supreme. Të tre këto pushtete që i kemi përmendur: pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor, kanë një qëllim kryesor. E ky qëllim është që ta bëjnë shtetin sa më funksional. Prandaj pjesëmarrja aktive e secilit qytetar bën që shteti të funksionoj më mirë.



Të gjithë duhet të jenë të lirë



Gazetarët e „Demos-ti“

QYTETARË TË MIRË PËR NJË VEND DEMOKRATIK

DRILON A. (14), ZYLQIFLI (15), MIRA (15), NIDA (15), SHPEND A.(14), DRILON K. (14),
GENTRIT (14), SHPEND Z. (15)

Sot kemi diskutuar për demokracinë, për të drejtat dhe për përgjegjësitë e qytetarëve

Në vendin tonë, ne kemi një problem të madh, i cili ka të bëjë me demokracinë, për të cilën do të flitet në këtë artikull. Është fjala për ndërtimin e demokracisë nga qytetarët aktiv. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë rend, apo me një fjalë demokracia është udhëheqja e popullit. Në demokraci, hyn gjithçka që ka të bëjë me popullin, e poashtu edhe qytetërimin. Qytetërimi në vendin tonë është më ndryshe se në vendet e huaja. Por, qytetërimi në Kosovë është duke u zhvilluar dita e ditës, sepse njerëzit kanë filluar të vetëdijësohen. Tek qytetërimi hynë: edukata, respekti, kultura, etj. Edukimi tek fëmijët duhet të fillojë që në moshë të hershme, sepse fëmijët këshillat që i marrin nga të rriturit, ata i përsërisin shumë shpesh në kokën e tyre. Çdo qytetarë i Kosovës duhet të ketë respekt për njëri - tjetrin si i riu për të moshuarin dhe anasjelltas. Kultura është një gjë shumë e rëndësishme për çdo qytetarë. Me kulturën që e marrim në familje, atë kulturë ne e tregojmë edhe në rrugë, në mbledhje, takime apo edhe kudo tjetër.

Ne si çdo qytetarë tjetër, kemi shumë të drejta dhe përgjegjësi, si p.sh.: të flasim lirshëm, të jemi të lirë, të shkollohemi, të drejtë për pjesëmarrje, etj. Këto ishin disa të drejtat tona, kurse të ndihmojmë të tjerët, të mësuarit, kryerja e detyrave të shtëpisë, etj., janë përgjegjësitë tona. Pra, ne mendojmë se nëse çdo qytetarë do t'i përdorë këto të drejta dhe përgjegjësi, atëherë qytetërimi në Kosovë do të zhvillohet edhe më shumë.




Ne jemi qytetarë të demokracisë



E drejta për të votuar! Ta mbajmë ambientin pastër!



Të drejtat pa dallime



Disa nga të drejtat dhe përgjegjësitë tona si qytetarë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë